

VENDIM
Nr.143, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT
TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Aplikimi i “CEZ shpërndarje” sh.a., për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, në kushtet kur është përcaktuar detyrimi i uljes së nivelit të humbjeve teknike e joteknike gjatë periudhës së tretë rregullatore dhe është miratuar studimi përkatës i cili shprehet mbi shpërndarjen e nevojave për investime në arritjen e targeteve të vendosura, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë, me kushtin e pikës 2 më poshtë, vlerat e investimeve të parashikuara në aplikimin e bërë nga “CEZ shpërndarje” sh.a., për çdo vit dhe të ndara sipas grupimeve sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Plani i investimeve miratohet me kushtin që investimet e zërave “Nënstacione dhe matje” të rishikohen dhe plotësohen nga “CEZ shpërndarje” sh.a. deri në 31 mars 2012 në frymën e observacioneve të bëra prezent nga ERE për dhënie prioritet investimeve me efektin më të shpejtë dhe me të lartë në zvogëlimin e humbjeve teknike e joteknike (linjat ABC etj.). Plani i rishikuar i investimeve do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE deri më 15 maj 2012.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani